



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:126057

Datë: 22.07.2020

Numri i dokumentit: 01034348

C.nr.1073/17

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Gjyqtari Fatmir Baloku, në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditësit M.SH nga Peja, të cilin e përfaqëson Z.R, avokate nga Peja, kundër të paditurit K.P nga Peja, Dardania I, Rr. Ardian Krasniqi nr.24, tani me adresë të panjohur, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm T.B, avokat nga Peja, me bazë juridike vërtetim i pronësisë, vlera e kontestit 1.000 euro, pas seancës së shqyrtimit kryesorë të datës 21.07.2020, jashtë seancës më datë 22.07.2020, bie këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **VËRTETOHET** se paditësi M.SH është pronar në bazë të mbajtjes me mirëbesim të palujtshmërisë e cila evidentohet si ngastër kadastrale me numër të njësisë...ZK Pejë, me kulturë oborr në sipërfaqe prej 166 m² dhe shtëpi prej 36 m², e në sipërfaqen e përgjithshme prej 202 m².
- II. **DETYROHET** i padituri P.K që paditësit M.SH t'ia njohë të drejtën e pronësisë në ngastrën kadastrale të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe të lejojë që paditësi si pronar, në bazë të këtij aktgjykimi, të regjistrohet në libra përkatës pronësorë pranë Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Pejë, në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e dorëzimit të aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.
- III. Secila nga palët i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarës së tij Z.R, avokate nga Peja, me datën 10.10.2017 ka parashtruar padi në këtë gjykatë me bazë juridike vërtetim i pronësisë, duke kërkuar që ti aprovohet kërkesëpadi dhe të vërtetohet se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale me numër...me sipërfaqe prej 202 m² si dhe të detyrohet i padituri P.K që paditësit t'ia njohë të drejtën e pronësisë në këtë ngastër dhe të lejojë që ai të regjistrohet si pronar i saj në ZKK në Pejë.

Pasi që vendbanimi i të paditurit P.K nuk është i njohur, gjykata vendosi me aktvendimin e datës 27.02.2020 që të paditurit në fjalë ti caktohet përfaqësues i përkohshëm avokati T.B nga Peja, i cili aktvendim është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës të Kosovës. me datën 10.03.2020.

E autorizuar e paditësit, Z.R avokate nga Peja, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Nga e gjithë rrjedha e procedurës, administrimi i provave si dalja në teren, ekspertiza e ekspertit gjeodet, dëgjimi i dëshmitarëve është vërtetuar në mënyrë të plotë se paditësi është pronar dhe posedues i vetëm i paluajtshmërisë kontestuese andaj gjykatës i propozojmë në bazë të gjitha të lartcekurave të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë si të bazuar.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit në fjalën përfundimtare deklaroi: Unë kam bërë përpjekje që të bie në kontakt me palën e paditur si përfaqësues i përkohshëm i tij por pa sukses. Lidhur me administrimin e provave dhe kërkesëpadinë e palës paditëse e kundërshtoj parimisht në tërësi dhe i propozoj gjykatës që të refuzoj kërkesëpadinë por gjithashtu gjykatës ia lë në vlerësim këtë çështje.

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata ka zhvilluar procedurën kontestimore dhe janë administruar këto prova: Dalja e gjykatës në vend të ngjarjes, ekspertiza e ekspertit F.H së bashku me kopjen e planit, skicën e matjes, ortofoto dhe fletën poseduese, deklarata e dëshmitarëve S.G dhe B.G në seancën e datës 21.07.2020 .

Pas vlerësimit të provave veç e veç e të gjitha në lidhshmëri reciproke e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në

përfundim se për këtë çështje kontestimore duhet të vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e nga arsyet siç vijon:

Me rastin e daljes në vend ngjarje gjykata së bashku me ekspertin gjeodet F.H., të autorizuarën e paditësit, Av Z.R dhe përfaqësuesin e përkohshëm të të paditurit avokatin T.B, ka konstatuar se në ngastrën kontestuese me numër të njësisë ..., e cila gjendet në..., në anën veri-jug në këtë ngastër është e ndërtuar shtëpia e banimit e tipit pjesërisht bodrum+P+1K, pjesa tjetër është oborr dhe gjelbërim. Në anën lindore janë edhe shkallët për hyrje në objekt në të cilën anë nuk ka kufinj ndarës por është e bashkangjitur me ngastrën e paditësit. Në anën veriore është e rrethuar me mur nga blloka të betonit – muri i fqijut. Në anën lindore është pjesërisht me shtylla metali dhe rrjetë metalike dhe pjesërisht me muri të shtëpijave të banimit.

Ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë F.H konstaton identifikimin e ngastrës kadastrale ...me kulturë oborr në sipërfaqe prej 166 m² dhe shtëpi prej 36 m² e gjithsej 202 m² e cila në evidencën kadastrale evidentohet në emër të K.P. Pas matjeve të detajishme në teren dhe kalkulimi të mëvonshëm eksperti ka konstatuar se paditësi në teren është duke mbajtur ngastrën kadastrale numër...në sipërfaqe prej 202 m², në kuadër të kësaj ngastre ka të ndërtuar shtëpinë e banimit të tipit Bodrum+P+1K në të cilën edhe banon këtu paditësi M.SH, ndërsa pjesa tjetër është oborr, e këto vërtetohen nga **kopja e planit me shënimet kadastale, ortofotot** dhe nga **skica e matjes** e cila tregon se për cilat njësi është parashtruar kërkesa e paditësit dhe si janë të ndarë kufijtë kadastral dhe kufiri i ngjizur i ndarjes.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike procedoi në cilësi të dëshmitarëve S.G dhe B.G.

Dëshmitari S.G, pasi u udhëzua që të flasë të vërtetën, deklaroi se: E di këtë çështje shumë mirë ku këtu paditësi nga ish pronari P K ka blerë ngastrën kontestuese ... që gjendet në lagjen.. që ka sipërfaqe prej 202 m². Aty ka qenë një shtëpi kur e ka blerë M. nga P.K, këtë shtëpi që tani gjendet në ngastër e ka ndërtuar M. mirëpo paraprakisht e ka rrëzuar shtëpinë e vjetër. Në atë kohë e ka blerë në dinarë jugosllav por se di vlerën. Kur ka bërë pazar unë kam qenë i pranishëm aty, kanë qenë edhe vëllezërit e mi I. dhe M. të cilët të dy në ndërkohë kanë vdekur, por kur janë dhënë paratë nuk kam qenë i pranishëm por e di që i ka paguar të gjitha të hollat. Diku pas 1 viti P K është shpërngulë nga Peja dhe nuk kam njohuri ku gjendet.

Dëshmitari B.G, pasi u udhëzua që të flasë të vërtetën, deklaroi se: Këtu paditësin M. e kam baxhanak, nuk kam qenë i pranishëm kur e ka blerë ngastrën kontestuese por nga biseda me M. e di që e ka ble në vitin 1990 dhe të gjitha të hollat i ka paguar në dinarë jugosllav dhe ka hyrë në posedim të ngastrës. Për gati 30 vite as ish pronari e as personat e tretë asnjëherë nuk e kanë penguar në posedim M. Shtëpinë e cila gjendet në këtë ngastër e ka ndërtuar Mi pasi që paraprakisht e ka rrënuar shtëpinë e vjetër, diçka tjetër nuk kam.

Duke u bazuar në faktet e vërtetuara më lartë edhe atë nga dalja në vend ngjarje e gjykatës, nga dëshmitë e dëshmitarëve dhe nga ekspertiza e ekspertit gjeodet F.H, vërtetohet se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale me numër ..me sipërfaqe prej 202 m² në ekspertizën e ekspertit e paraqitur me ngjyrë të kaltër me dimensione si në skicën e matjes përgjatë tërë anëve gjeografike.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike është vërtetuar se paditësi ka fituar të drejtën e pronësisë nga baza e mbajtjes me mirëbesim të ngastrës kontestuese të cekur si në dispozitiv të aktgjykimit e në kuptim të dispozitave të nenit 40 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.

Pasi që pala paditëse nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi që secila nga palët të i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Prandaj, nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me datë 22.07.2020.

Gj y q t a r i
Fatmir Baloku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e dorëzimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykatë.